



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

Nr. 2174 prot.

Tiranë, më 27.03.2024

PËR SHPALLJE PROCEDURE PËR VEND TË LIRË  
PUNE

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shpall pozicionin si më poshtë:

- Për 2 (dy) vende, në pozicionin *Punonjës Gjykatë, (ftues)*,

**Kërkesa të përgjithshme**, kandidati duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e përgjithshme sipas ligjit nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit Nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Përshkrimi** i përgjithshëm i punës për pozicionin *punonjës gjykatë (ftues)* është si më poshtë:

1. Njoftimi i zhvillimit të procesit gjyqësor për palët ndërgjyqëse së bashku me aktetshoqëruese bëhet nga *Punonjësi i Gjykatës*, në rrugë elektronike nëse palët kanë paraqitur dhe dhënë pëlqimin e tyre për përdorimin e adresës elektronike ose në të kundërt, ai kryhet në rrugë postare.
2. Punonjësi i Gjykatës regjistron personin e autorizuar për marrjen e njoftimit në portalin elektronik kombëtar të administruar nga KLGJ.
3. Punonjësi i Gjykatës përpara nisjes së njoftimit bën kontrollin paraprak të saktësisimit të adresës së palës ndërgjyqëse ndaj të cilit/ës ushtrohet padia.
4. Në rast konstatimi se adresa është e paplotë, punonjësi i gjykatës kthen njoftimin (letërthirrjen) pranë sekretarit gjyqësor.
5. Punonjësi i gjykatës në bashkëpunim me sekretarin gjyqësor realizon kërkime në lidhje me adresën e personit që i drejtohet ankimi, në adresën elektronike të depozituesit të padisë duke kërkuar saktësi të adresave brenda një afati të caktuar kohor, bën kërkime në regjistrat publikë, në organe të Administratës Shtetërore, në vendqëndrimin ose vendbanimin e fundit, në familje ose tek të afërmit të personit që i drejtohet njoftimi dhe në përfundim raporton mbi gjetjet emundshme.
6. Punonjësi i gjykatës merr të gjithë masat e nevojshme për gjetjen e adresës së personit që i drejtohet ankimi.
7. Nëse procesi i lartpërmendur rezulton i pasuksesshëm ai pasqyrohet në një procesverbal të veçantë të hartuar nga sekretari gjyqësor dhe të nënshkruar edhe nga punonjësi i gjykatës. Procesverbali bëhet pjesë e dosjes gjyqësore.

8. *Punonjësi i Gjykatës* kujdeset për orientimin e publikut dhe palëve brenda nëgjykatë, si dhe për njoftimin dhe futjen në seancë të dëshmitarëve, pasi t'i jetënjoftuar ky fakt paraprakisht nga sekretarja e seancës.

9. *Punonjësi i gjykatës* kryen edhe të gjitha detyrat e tjera të parashikuara nga kodete procedurave, vendimi për solemnitetin, si dhe detyra të tjera të ngarkuara ngadretuesit e gjykatës dhe gjyqtarët.

**Kërkesat e veçanta** janë si më poshtë:

- Të jetë i diplomuar.
- Të ketë përvojë të paktën një vit eksperience pune.
- Të ketë aftësi komunikimi me të gjithë marrësit e shërbimit të Gjykatës, brenda dhe jashtë saj;

**Kandidati** duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **29.03.2024**, pranë zyrës së Burimeve Njerëzore të Gjykatës së Shkallës së Parë Të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nëpërmjet postës, dokumentet e mëposhtëm:

- Kërkesë për aplikim në vendin e punës që konkurren.
- Jetëshkrimin e përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës,
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore).
- Kontaktet (*numër telefoni dhe adresë e-mail*) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi.

**Verifikimi paraprak**, i përmbushjes së kushteve minimale për pozicionin e punës do të kryhet në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë Të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe pas njoftimit të kandidatëve fitues në fazën e parë do të kryhet **intervista** e strukturuar me gojë.

#### **IV. DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

**Data** e daljes së rezultateve do të shpallet në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al)